



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Prill 2024

Data 29.04.2024 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i ditës:

- 1.Projekt vendim për humbjen e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Vau Dejës.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2024.
- 3.Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.
- 4.Projekt vendim mbi përfundimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme familjeve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019.
- 5.Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit të sipërfaqes prej 20 ha, pjesë e pasurisë nr.148, Zk nr.2993 e llojit “ Kullotë “, në fshatin Plezhë, Nj.Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës “Për ndërtim parku fotovoltai, aerogeneratorë(stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)
- 6.Të ndryshme

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Prill 2024, u zhvillua me datë 29.04.2024 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 17 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e ditës dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Projekt vendim për humbjen e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

Z.Ervis shimaj sqaron këshilltarët se këshilltarja Znj.Paola Pleshaj, ka munguar 6 muaj rresht në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Vau Dejës pa ndonjë arsye dhe konkretisht nga muaji Tetor 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

deri në muajin Mars 2024 dhe mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 49, pika 4, germa e, dhe në rregulloren nr.23 datë 24.04.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës” neni 21, pika 1, germa g, komisioni i mandateve ka propozuar miratimin e humbjes së mandatit të këshilltares Znj.Paola Pleshaj perfaqësuese e subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi-perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Mars 2024, te perfitojne 139 familje, me 470.007 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Mars 2024 janë shpallur fitues, 1.032 familje, me fond 7.846.908 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 470.814 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Renato Doda- pergjegjes i zyres finance buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejes, i cili spjegon per këshilltarët se projekt vendimi ka për qëllim përmirësimin e vkb 91/2023. Projekt vendimi është hartuar konform ligjit dhe VKM-ve, nga ku Bashkia Vau Dejes për vitin 2024 vazhdon të mbështesë politikat e ndermarra për ruajtjen e nivelit ekonomik. Projekt vendimi perfshin rishperndarjen e fondeve buxhetore të Bashkisë, kjo sipas bashkefinancimit me Këshillin e Qarkut Shkoder për rikonstruksionin e rruges Trush i Poshtëm, mbikqyrje plus kolaudim, sipas aktmarrëveshjes nr.64/1 datë 09.04.2024 dhe Vendimit nr.5 date 09.04.2024 të Këshillit të Qarkut, bashkëngjitur projekt vendimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi përfundimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme familjeve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Valjeta Nikaj-pergjegjese e zyres emergjencave civile, e cila spjeron per keshilltarët se nga pasojat e tërmetit të datës 26.11.2019, 9 familje janë dëmshpërblyer gjatë vitit 2020,2022 dhe 2023 deri në 35% e vlerës së dëmit dhe me këtë projekt vendim propozohet që të kompensohen edhe 15% të vlerës totale të dëmit për të mbuluar masen 50% të kompensimit, me fonde te Buxhetit të shtetit, akorduar Bashkisë Vau Dejës për këtë qëllim.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit të sipërfaqes prej 20 ha, pjesë e pasurisë nr.148, Zk nr.2993 e llojit “ Kullotë “, në fshatin Plezhë, Nj.Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës “Për ndërtim parku fotovoltai, aerogjeneratorë(stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj).

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Ndoc Baqli-pergjegjes i zyres asetëve i cili spjeron për këshilltarët se me date 25.04.2024 është realizuar dëgjese publike me banorët e fshatit Plezhë nga ana e Këshillit Bashkiak dhe se te pranishmit kishin shprehur dakortesi per projekt vendimin e paraqitur. Pas marrjes së vendimit nga Këshilli dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit Qarkut, sipërfaqja e mesiperme e cila do ti nënshtrohet procedures se prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, do të zbatohet edhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “ Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytezim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca 1, pika 8/4.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Pika 6 të ndryshme: Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për të diskutuar për probleme te ndryshme.

Z.Samed Hasmeqaj ngre shqetësimin e pastrimit të barërave dhe mbeturinave në fshatin Mjedë, meqenese jemi afer sezonit turistik.

Znj.Leonora Prenga kërkon sistemimin e oborrit të shkollës Hajmel.

Z.Martin Mardoda kerkon që segmenti rrugor Mjed,Kaç,Naraç,anash asfaltit të vendoset çakull.

Z.Kristian Shkreli-Kryetar Bashkie, premtion se këto shqetësime do verifikohen dhe do sistemohen



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbasi nuk kishte pyetje apo diskutime të tjera, mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës e datës 29.04.2024 deklarohet e mbyllur nga kryetari këshillit.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

Enis Shiuq
Beharë Inani
Erinda Kalo
Onela Lleshi
Frano Prapo
Melike Zyberaj
Besmir Kops

